



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti, gjykatës raportues

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 12 korrik 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi të drejtat procedurale të viktimave gjatë gjykimit**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të të Akuzuarit**

Julius von Bone

**Zyrës Administrative**

Shefes së Zyrës së Pjesëmarrjes së  
Viktimave

Zilke Shtuxhinski

**Mbrojtëses së viktimave**

Ani Pues

**Trupi Gjykses I** (Trupi Gjykses) lëshon këtë vendim mbi të drejtat procedurale të viktimave gjatë gjykimit.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>1</sup>

2. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi "Vendimin e Dytë Mbi Pjesëmarrjen e Viktimave", me të cilin miratoi pjesëmarrjen e pesë viktimave në këtë çështje gjyqësore dhe urdhëroi Administratoren që deri të premtën, 7 maj 2021, të caktonte një mbrojtës për viktimat e përfaqësuara si Grupi 1.<sup>2</sup>

3. Më 20 maj 2021, Trupi Gjykses lëshoi "Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)", ku përcaktoi se procesi i zhdëmtimit duhet të kryhet paralelisht me procesin penal, në pajtim me kornizën ligjore të zbatueshme para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("DHSK").<sup>3</sup>

4. Më 20 maj 2021, Trupi Gjykses lëshoi "Vendimin për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët", me të cilin i kërkoi mbrojtëses së viktimave të paraqiste parashtrimet e veta, ndër të tjera për çështje në lidhje me paraqitjen e provave, marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe pranueshmërinë e provave jогоjore.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Një version i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar u protokollua më 28 shtator 2020, F00019/A01.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00105/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 30 prill 2021, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F000124, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* (Vendimi mbi Caktimin e Ekspertit(Ekspertëve)), 20 maj 2021, publik. Parashtrimi u njoftua më 21 maj 2021.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F000123, Trupi Gjykses I, *Vendim për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët*, 20 maj 2021, publik, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 10, pikat 4.e, 5.c, 6; 14; 17(d).

5. Më 21 maj 2021, Trupi Gjykses lëshoi “Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”, me të cilin pranoi katër viktima si viktima pjesëmarrëse në proces, zgjati afatin për paraqitjen e kërkesave të viktimave për pjesëmarrje në proces dhe përcaktoi të drejtat procedurale të viktimave gjatë procesit gjyqësor.<sup>5</sup>

## II. LIGJI I ZBATUESHËM

6. Trupi Gjykses vë në dukje nenet 22(3) dhe (5)-(6) dhe 23 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 80, 114, dhe 132 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).

7. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje rregullën 4(1) të Rregullores sipas të cilës “[r]regullorja interpretohet në pajtim me kornizën e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit, dhe nëse është e përshtatshme, me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës” (“KPPK”).

## III. ANALIZË

### A) VËREJTJE TË PËRGJITHSHME

8. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se të drejtat e viktimave gjatë procesit gjyqësor kufizohen domosdoshmërisht në çështjen gjyqësore që shqyrton Trupi Gjykses dhe si pasojë duhen ushtruar brenda kufijve të Aktakuzës së Konfirmuar ashtu si i është kaluar Trupit Gjykses nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në pajtim me Rregullën 98(1) të Rregullores, në varësi të çdo ndryshimi që mund t’i bëhet asaj Aktakuze të Konfirmuar, në pajtim me nenet 39(8) dhe 40(7) të Ligjit dhe rregullën 90 të Rregullores. Kjo konfirmohet nga rregulla 113(1) dhe (4) e Rregullores ku

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F000126/RED, Trupi gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), 21 maj 2021, publik.

thuhet se, për t'u pranuar si viktimë pjesëmarrëse në proces, një person duhet të japë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale të përfshirë në Aktakuzë.

#### B) INTERESAT PERSONALE DHE TË DREJTAT E VIKTIMAVE

9. Në lidhje me procedurat para DHSK-së, neni 22(3) i Ligjit përmend tre “interesa personale dhe të drejta të viktimës në procedurën penale”: njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.

10. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se Ligji nuk shpjegon dallimin që bën midis “interesave personale” dhe “të drejtave” të viktimave. Trupi Gjykses e kupton në këtë kontekst se ekzistenca e “interesave personale” i lejon viktimat të ushtrojnë “të drejta” procedurale para DHSK-së.

11. Për mendimin e Trupit Gjykses, fakti që krahas “zhdëmtimit” përmenden edhe “njoftimi” dhe “pranimi” nënkupton se pjesëmarrja e viktimave në proceset para DHSK-së nuk kufizohet vetëm në zhdëmtimin për dëmin e pësuar. Për më tepër, Trupi Gjykses është i mendimit se mbrojtja e viktimave e parashikuar në nenin 23 të Ligjit duhet t'u shtohet tre interesave personale dhe të drejtave të lartpërmendura, ku paragrafi 2 në veçanti i jep mbrojtësit të viktimave të drejtën për të bërë parashtrime para cilitdo paneli në lidhje me masat mbrojtëse.<sup>6</sup> Megjithëse nuk përmendet shprehimisht në nenin 22 të Ligjit, mbrojtja e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së viktimave duhet kuptuar si pjesë thelbësore e interesave personale dhe të drejtave të viktimave.

12. “Zhdëmtimi” si interes personal dhe e drejtë e viktimave shtjellohet më tej në nenet 22(7) dhe (8) dhe 44(6) të Ligjit dhe në rregullën 168 të Rregullores. Për sa i takon

---

<sup>6</sup> *Shih gjithashtu, Rregulla 80 e Rregullores.*

procesit të zhdëmtimit që eventualisht mund të rezultojë në nxjerrjen e Urdhrit për Zhdëmtim në pajtim me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit,<sup>7</sup> Trupi Gjykses vlerëson se ky proces është brenda fushëveprimit të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”). Rrjedhimisht, viktimat gëzojnë të drejtat procedurale sipas atij neni për sa u takon kërkesave të tyre për zhdëmtim.<sup>8</sup> Kjo përfshin të drejtën për të paraqitur parashtrime dhe prova të cilat viktimat i gjykojnë të rëndësishme për mbështetjen e kërkesave të tyre për zhdëmtim, si edhe detyrën e Trupit Gjykses përkatës për të kryer vlerësimin e duhur të argumenteve, parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga viktimat në këtë kontekst.<sup>9</sup>

13. Ndonëse Ligji jep disa sqarime në lidhje me kuptimin e “zhdëmtimit”, kjo nuk vlen për “njoftimin” dhe “pranimin” për të cilat Ligji nuk jep asnjë përkufizim.

14. Për sa i takon “njoftimit”, Trupi Gjykses është i mendimit se “njoftimi” ka të bëjë me interesin personal dhe të drejtën e viktimave për t’u informuar në lidhje me proceset para DHSK-së, në mënyrë që atyre t’u mundësohet pjesëmarrje në ato procese. Kjo e drejtë parashikohet në disa tekste juridike ndërkombëtare.<sup>10</sup>

15. Në lidhje me këtë, megjithëse Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (“ZPV”) e Zyrës Administrative, në pajtim me mandatin e saj të parashikuar në rregullën 23(5) të Rregullores, është përgjegjëse për informimin e viktimave në përgjithësi për gjykimet e çështjeve të ndryshme gjyqësore para DHSK-së,<sup>11</sup> edhe mbrojtësi i viktimave i

<sup>7</sup> *Shih*, Vendimi mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve), para. 9.

<sup>8</sup> ECtHR/GJEDNJ, *Perez v. France* [GC], nr. 47287/99, [Judgment](#) (*Perez v. France* [GC]), 12 February 2004, para 71.

<sup>9</sup> ECtHR/GJEDNJ, *Perez v. France* [GC], para. 80. *Shih gjithashtu*, ECtHR/GJEDNJ, [Van de Hurk v. the Netherlands](#), no. 16034/90, *Judgment*, 19 April 1994, para. 59.

<sup>10</sup> UN General Assembly, [Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power](#) (UN Declaration of Basic Principles of Justice), U.N. Doc. A/RES/40/34, 29 November 1985; para. 6(a); [Recommendation No. R \(85\) 11 of the Committee of Ministers of the Council of Europe to Member States on the Position of the Victim in the Framework of Criminal and Procedure](#), 28 June 1985, para. 9. *Shih gjithashtu*, referencën e GJEDNJ-së ndaj këtij Rekomandimi në çështjen [Perez v. France](#) [GC], para. 27, 72.

<sup>11</sup> *Shih gjithashtu*, neni 22 i Ligjit.

informon rregullisht klientët e vet për zhvillimet përkatëse në lidhje me çështjen gjyqësore, në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores.

16. Sa i takon “pranimi”, Trupi Gjykes vlerëson se, në kontekstin e procesit penal para DHSK-së që lidhet me marrjen e vendimit mbi akuzat kundër të akuzuarit të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar,<sup>12</sup> “pranimi” duhet të kuptohet si interesi personal dhe e drejta e viktimave për t’iu njohur dëmi që pretendohet se kanë pësuar dhe, në këtë mënyrë, përmes modaliteteve të pjesëmarrjes së tyre në proces, të kontribuojnë në mënyrë të njemendte në njohjen e atij dëmi dhe të përgjegjësisë së personave që e kanë shkaktuar atë.

17. Ky interpretim është në përputhje me – së pari – konstatimet e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese se viktimat kanë të drejtën themelore “për hetim të pavarur dhe të efektshëm në bazë të garancive procedurale të neneve 25 dhe 27 të Kushtetutës dhe neneve 2 dhe 3 të Konventës”<sup>13</sup> dhe – së dyti – me konstatimin e Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në aktvendimin e saj në çështjen *El-Masri*.<sup>14</sup> Dhoma e Madhe theksoi rëndësinë e të drejtës për të vërtetën, jo vetëm për viktimën dhe familjen e tij, por edhe për viktimat e tjera në çështje të ngjashme dhe për publikun e gjerë që kishte të drejtë të dinte se çfarë kishte ndodhur.<sup>15</sup> Dhoma e Madhe erdhi në përfundimin se parashtuesi i kërkesës ishte

---

<sup>12</sup> *Shih gjithashtu*, por si një formë kënaqësie për viktimat nga një falje publike, duke përfshirë njohjen e fakteve dhe pranimin e përgjegjësisë, UN General Assembly, [Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law](#), U.N. Doc. A/RES/60/147, 16 December 2005, para. 22(e).

<sup>13</sup> *Shih*, KSC-CC-2020-11, F00015, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Judgment on the Referral of Proposed Amendments to the Constitution of Kosovo](#)/Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të propozuara të Kushtetutës së Kosovës, 26 nëntor 2020, publik, para.69, 75. “Konventa” i referohet GJEDNJ-së.

<sup>14</sup> ECtHR/GJEDNJ, *El-Masri v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia* [GC], no. 39630/09, [Judgment \(El-Masri v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia\)](#) [GC], 13 December 2012.

<sup>15</sup> ECtHR/GJEDNJ, [El-Masri v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia](#) [GC], para. 191. *Shih gjithashtu*, ECtHR/GJEDNJ, *Abu Zubaydah v. Lithuania*, no. 46454/11, [Judgment \(Abu Zubaydah v. Lithuania\)](#), 31 May 2018, para. 610.

privuar nga “informimi lidhur me atë që kishte ndodhur, përfshirë marrjen e një përshkrimi të saktë të vuajtjeve që pretendohet se kishte pësuar dhe të rolit të personave përgjegjës për vuajtjet e pretenduara” dhe se, si rrjedhojë, ishte kryer shkelje e garancive procedurale të nenit 3 të KEDNJ-së.<sup>16</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se pranimi i shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare është një lloj mase ndreqëse po aq e rëndësishme, apo edhe më e rëndësishme se e drejta për kompensim.<sup>17</sup>

18. Interpretimi i lartpërmendur është në pajtim edhe me Rregulloren. Në këtë kontekst, për dallim nga palët, mbrojtësi i viktimave nuk ka të drejtën e pavarur të paraqitjes së provave por, në pajtim me rregullën 114(5) të Rregullores, vetëm mund t'i kërkojë Trupit Gjykses të urdhërojë paraqitjen e provave përkatëse, apo të thërrasë dëshmitarët për të dhënë dëshmi. Ushtrimi i kompetencës së Trupit Gjykses për të urdhëruar paraqitjen e provave, në pajtim me rregullën 132 të Rregullores, nga ana tjetër, varet nga konstatimi i Trupit Gjykses se kjo është “e domosdoshme për përcaktimin e së vërtetës”. Rrjedhimisht, edhe Rregullorja e kushtëzon pashmangshmërisht të drejtën e viktimave për pjesëmarrje në proces dhe paraqitje të provave me përcaktimin e të vërtetës në lidhje me atë që pretendohet se u ka ndodhur dhe përgjegjësinë e personave të përfshirë. Gjithsesi, Trupi Gjykses do të zbatojë rregullat 114(5) dhe 132 të Rregullores për të siguruar që viktimat të kenë mundësi të njëmendtë të ushtrojnë këtë të drejtë gjatë procesit gjyqësor.

19. Për mendimin e Trupit Gjykses, një përfundim i tillë mbi të drejtat e viktimave në procedime penale para DHSK-së në asnjë mënyrë nuk ndikon në faktin që është plotësisht detyrë e ZPS-së të vërtetojë sipas standardit të kërkuar elementet e

---

<sup>16</sup> ECtHR/GJEDNJ, *El-Masri v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia* [GC], para. 192-194. *Shih gjithashtu*, ECtHR/GJEDNJ, *Abu Zubaydah v. Lithuania*, para. 620.

<sup>17</sup> *Shih gjithashtu*, ECtHR/GJEDNJ, *El-Masri v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia* [GC], Joint Concurring Opinion of Judges Tulkens, Spielmann, Sicilianos and Keller, para. 6.



ndryshme të krimeve të përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

C) TË DREJTAT PROCEDURALE TË VIKTIMAVE NË PROCESE PENALE DHE TË ZHDËMTIMIT

20. Neni 22(5) dhe (6) i Ligjit thekson se viktimat mund të marrin pjesë në procese gjyqësore para DHSK-së vetëm përmes mbrojtësit të viktimave, duke përjashtuar kështu vetëpërfaqësimin, dhe i referohet Rregullores në lidhje me përcaktimin e modaliteteve të pjesëmarrjes së viktimave në proces.

21. Rregulla 114 e Rregullores parashikon - pa i shtjelluar me hollësi të shumta - modalitetet e mëposhtme në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave në proces përmes mbrojtësit të viktimave: bërjen e deklaratave hyrëse dhe përmbyllëse në pajtim me rregullat 126(3) dhe 135 të Rregullores; praninë gjatë procesit gjyqësor; qasjen në material konfidencial; paraqitjen e parashtrimeve me gojë dhe me shkrim; pyetjen e dëshmitarëve; dhe kërkesën ndaj Trupit Gjyqësor për të urdhëruar paraqitjen e provave përkatëse apo thirrjen e dëshmitarëve për të dëshmuar.

22. Trupi Gjyqësor është i mendimit se në këtë çështje, të drejtat procedurale të viktimave kërkojnë nxjerrjen e udhëzimeve konkrete të mëtejshme sipas rregullës 114(4) të Rregullores. Në këtë kontekst, krahas që i referohet nenit 22(3) dhe (6) të Ligjit, rregulla 114(4) e Rregullores gjithashtu i jep Trupit Gjyqësor kompetencë të përcaktojë udhëzime të tilla brenda kornizës së parashikuar në Ligj dhe në Rregullore.

23. Megjithatë, Trupi Gjyqësor thekson se modalitetet e pjesëmarrjes në proces, të parashtruara më poshtë, mbeten në çdo kohë nën kontrollin e Trupit Gjyqësor dhe në raste të caktuara mund të ndryshohen, në qoftë se nuk preken interesat personale të viktimave. Për më tepër, në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit, Trupi Gjyqësor duhet gjithashtu të sigurojë që pjesëmarrja e viktimave në proces të mos cenohet të drejtat e të akuzuarit dhe të jetë në përputhje me to.



24. Trupi Gjykses fillimisht rikujton vendimin e vet të mëparshëm me të cilin përcaktoi tre modalitetet e mëposhtme të pjesëmarrjes së viktimave në proces.

### 1. Qasja në dosjen e çështjes

25. Sipas rregullës 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka qasje në të gjithë dosjen e çështjes, duke përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese, publike, konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes.<sup>18</sup> Po kështu, mbrojtësi i viktimave informohet për të gjitha materialet e shpërndara që i përkasin dosjes së çështjes, ku përfshihen të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet, dhe nxjerrjet e materialeve provuese, publike, konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale, me përjashtim të materialeve të shpërndara *ex parte* të dosjes së çështjes.<sup>19</sup> Mbrojtësi i viktimave i informon rregullisht viktimat pjesëmarrëse në proces ("VPP") për zhvillimet përkatëse në çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione jopublike.<sup>20</sup>

### 2. Prania në seancat gjyqësore

26. Në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe Rregullën 114(2) të Rregullores dhe për të garantuar përfaqësimin e duhur të interesave personale të VPP-ve në çdo kohë, mbrojtësi i viktimave është i pranishëm në të gjitha seancat e gjykimit, duke përfshirë ato publike, të mbyllura apo private, me përjashtim të seancave *ex parte*.<sup>21</sup> Për këtë qëllim, mbrojtësi i viktimave informohet paraprakisht për të gjitha seancat që

---

<sup>18</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 38.

<sup>19</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 38.

<sup>20</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 38.

<sup>21</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 39.

zhvillohen para Trupit Gjykses.<sup>22</sup> Mbrojtësi i viktimave gjithashtu mund të kërkojë t'i drejtohet Trupit Gjykses gjatë një seance *ex parte*.<sup>23</sup>

### 3. Parashtrimet me gojë dhe me shkrim

27. Sikurse parashikohet në nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(4) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave lejohet të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim për çdo pikë juridike ose faktike, si dhe të parashtrijë përgjigje dhe kundërpërgjigje ndaj çdo parashtrimi që bëhet para Trupit Gjykses në përputhje me rregullën 76 të Rregullores.<sup>24</sup> Për të siguruar një modalitet të pjesëmarrjes pa pengesa dhe efikas, mbrojtësit të viktimave nuk i kërkohet që të kërkojë paraprakisht leje për të bërë parashtrime me gojë dhe me shkrim.<sup>25</sup> Këto parashtrime duhet të jenë në lidhje me interesat personale të viktimave, siç parashikohet në nenin 22(3) të Ligjit.<sup>26</sup>

28. Krahas modaliteteve të përcaktuara më lart, Trupi Gjykses do të përcaktojë edhe udhëzime të tjera në lidhje me paraqitjen e provave sipas urdhrimit të Trupit Gjykses, pyetjen e dëshmitarëve nga mbrojtësi i viktimave dhe paraqitjen e parashtrimeve të mbrojtësit të viktimave në lidhje me pranueshmërinë e provave të paraqitura nga palët.

### 4. Paraqitja e provave sipas urdhrimit të Trupit Gjykses

29. Në lidhje me renditjen e paraqitjes së provave gjatë gjykimit, në përputhje me rregullën 127(2) të Rregullores, përveçse kur urdhërohet ndryshe nga Trupi Gjykses, së pari paraqiten provat e Prokurorit të Specializuar, pastaj provat e Mbrojtjes, nëse

---

<sup>22</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 39.

<sup>23</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 39.

<sup>24</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 40.

<sup>25</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 40.

<sup>26</sup> Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 40.

ka, dhe së fundi, provat e kërkuara nga Trupi Gjykses *proprio motu* sipas rregullës 132 të Rregullores.

30. Nuk ka asgjë të parashikuar konkretisht lidhur me provat e kërkuara nga Trupi Gjykses me kërkesë të mbrojtësit të viktimave sipas rregullës 114(5) të Rregullores. Megjithatë, në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vë në dukje nenin 327 të KPPK-së i cili parashikon se, pas fjalës hyrëse, provat paraqiten sipas radhës së mëposhtme: së pari, provat e paraqitura nga prokurori i shtetit; pastaj provat e paraqitura nga i dëmtuari, dhe së fundi, provat e paraqitura nga i pandehuri. Po kështu, neni 331(1) i KPPK-së parashikon që “[k]ryetari i trupit gjykses cakton radhën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, duke filluar me dëshmitarët e propozuar nga prokurori i shtetit, dëshmitarët e propozuar nga i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave dhe në fund me dëshmitarët e propozuar nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij”. Duke interpretuar Rregulloren, sipas rastit në përputhje me KPPK-në bazuar në rregullën 4(1) të Rregullores, Trupi Gjykses është i mendimit se në këtë çështje, viktimat duhet të paraqesin provat e tyre, nëse kanë, sipas urdhrit të Trupit Gjykses, pas Prokurorit të Specializuar dhe përpara Mbrojtjes. Një renditje e tillë e paraqitjes së provave gjithashtu do t’i jepte mundësi Mbrojtjes që gjatë paraqitjes së provave të veta, t’u përgjigjet si provave të paraqitura nga ZPS-ja, ashtu edhe provave të paraqitura nga mbrojtësi i viktimave, nëse do të ketë.

31. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se, kur një dëshmitar paraqitet në gjykatë për të dhënë dëshmi, të dyja palët, si edhe mbrojtësi i viktimave, duhet të përpiqen t’i bëjnë atij dëshmitari të gjitha pyetjet që i konsiderojnë të nevojshme, nën mbikëqyrjen e kryegjykatësit, për të shmangur rithirrjen e atij dëshmitari në kuadër të paraqitjeve përkatëse të provave nga palët.

32. Gjithashtu, Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se menjëherë pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, Mbrojtja mund të bëjë të ditur

synimin e vet për të paraqitur mocion për rrëzimin e ndonjë akuze, apo të gjitha akuzave në Aktakuzën e Konfirmuar, në pajtim me rregullën 130(1) të Rregullores. Në një rast të tillë, Trupi Gjykses mund të trajtojë fillimisht një mocion të tillë përpara se të lejojë paraqitjen e provave nga mbrojtësi i viktimave.

33. Për të siguruar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor, në fund të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar Trupi Gjykses mund të vendosë të mbajë një konferencë mbi ecurinë e çështjes për të organizuar: (i) paraqitjen e provave nga mbrojtësi i viktimave për përcaktimin e së vërtetës, sipas urdhrorit të Trupit Gjykses; dhe (ii) paraqitjen e provave për zhdëmtimin.

34. Për këtë qëllim, mbrojtësi i viktimave paraqet listën e vet të dëshmitarëve (ekspertë) të propozuar për t'u thirrur nga Trupi Gjykses, paraprakisht dhe në kohë të mjaftueshme para përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar. Mbrojtësi i viktimave tregon se në çfarë mase dëshmitë apo ekspertiza e dëshmitarëve të propozuar ka të bëjë me interesat personale dhe të drejtat e viktimave, d.m.th. me përcaktimin e së vërtetës dhe/ose zhdëmtimin. Gjithashtu, kur dorëzon listën e vet, mbrojtësi i viktimave bën të ditur: (i) emrin dhe pseudonimin, sipas rastit, të secilit dëshmitar; (ii) nëse dëshmitarët e propozuar janë viktima që i përfaqëson apo persona të tjerë; (iii) një përmbledhje të fakteve për të cilat dëshmitarët e propozuar priten të dëshmojnë; (iv) nëse dëshmitarët e propozuar do të dëshmojnë personalisht në selinë e gjykatës apo do të japin dëshmi në ndonjë nga mënyrat e tjera të parashikuara në Rregullore; (v) përlllogaritje të kohëzgjatjes së pyetjeve të drejtpërdrejta për çdo dëshmitar të propozuar dhe renditjen e propozuar të paraqitjes së tyre; (vi) nëse gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të propozuar mbrojtësi i viktimave ka ndërmend të përdorë ndonjë material, dhe, nëse po, t'ia parashtrijë atë material Trupit Gjykses; dhe (vii) nëse për ndonjë prej dëshmitarëve të propozuar janë të nevojshme masa mbrojtëse dhe, sipas rastit, redaktimet e propozuara në

materialin e tyre, si dhe në çdo material tjetër që do të përdoret gjatë marrjes së tyre në pyetje.

35. Paraprakisht dhe në kohë të mjaftueshme para përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, mbrojtësi i viktimave gjithashtu bën të ditur nëse dëshiron që Trupi Gjykses të urdhërojë paraqitjen e provave jогоjore përkatëse në lidhje me interesat personale dhe të drejtat e viktimave. Gjithashtu, mbrojtësi i viktimave duhet të dorëzojë listën e materialeve të tilla të propozuara, ku të tregojë qartë nëse materialet kanë të bëjë me përcaktimin e së vërtetës dhe/ose zhdëmtimin, si edhe nëse dhe çfarë redaktimesh të atyre materialeve janë të nevojshme.

36. Në lidhje me procesin e zhdëmtimit, Trupi Gjykses rikujton se është detyrë e mbrojtësit të viktimave që të paraqesë prova, ndër të cilat dëshmi ekspertësh, në lidhje me kërkesat e viktimave për zhdëmtim. Në këtë kontekst, mbrojtësi i viktimave gjithashtu mund t'i kërkojë ZPS-së të nxjerrë çdo material apo provë që ka në zotërim, që mund të mbështesë kërkesat për zhdëmtim. Sikurse është vënë në dukje më parë, Trupi Gjykses duhet të lejojë mbrojtësin e viktimave të paraqesë çfarëdo prove me rëndësi në mbështetje të kërkesave të viktimave për zhdëmtim, duke respektuar kështu të drejtat e viktimave sipas nenit 6(1) të GJEDNJ-së.<sup>27</sup>

37. Paraprakisht dhe në kohë të mjaftueshme para përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, mbrojtësi i viktimave gjithashtu mund t'i kërkojë Trupit Gjykses autorizim që viktimat që përfaqëson t'i drejtohen drejtpërdrejt Trupit Gjykses, jo si dëshmitarë, por për të paraqitur pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre.<sup>28</sup> Trupi Gjykses pranon se kjo mund të jetë një mënyrë që viktimat të nxisin njohjen e dëmit të pësuar, në pajtim me nenin 22(3) të Ligjit. Paraqitja e pikëpamjeve dhe shqetësimeve nga viktimat nuk do të jetë objekt i pyetjeve nga palët dhe nuk do

---

<sup>27</sup> *Shih më lart*, para. 12.

<sup>28</sup> *Shih*, UN Declaration of Basic Principles of Justice, para. 6(b).

të konsiderohet si dëshmi nga Trupi Gjykses. Nëse vlerëson se informacioni që jep viktimë mund të jetë i domosdoshëm për përcaktimin e së vërtetës, Trupi Gjykses ka të drejtë ta thërrasë atë viktimë si dëshmitar, në pajtim me rregullën 132 të Rregullores.

38. Së fundi, në pajtim me nenet 39(13) dhe 40(6)(a) të Ligjit, mbrojtësi i viktimave mund t'i kërkojë Trupit Gjykses lëshimin e çfarëdo urdhri që mund të ndihmojë në përgatitjet e mbrojtësit të viktimave për paraqitjen e provave.

## 5. Pyetja e dëshmitarëve nga mbrojtësi i viktimave

39. Trupi Gjykses vëren se megjithëse rregulla 114(4)(b) parashikon mundësinë që mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e Trupit Gjykses, t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, përveç referencës "kurdoherë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në procesin gjyqësor", Rregullorja nuk parashikon renditjen sipas të cilës pyetja e dëshmitarëve duhet të zhvillohet, apo llojin e pyetjeve që mund t'u bëhen dëshmitarëve nga mbrojtësi i viktimave.

40. Në lidhje me llojin e pyetjeve që mbrojtësi i viktimave mund t'u bëjë dëshmitarëve, Trupi Gjykses nuk dëshiron t'i kufizojë ato pyetje *a priori*. Për më tepër, rregulla 114(4) e Rregullores nuk përmban ndonjë kufizim konkret në këtë drejtim. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se pyetja e dëshmitarëve në lidhje me vërtetimin e elementëve përbërës të krimeve dhe formave të përgjegjësisë penale në Aktakuzën e Konfirmuar është para së gjithash përgjegjësi e ZPS-së. Po ashtu, është para së gjithash përgjegjësi e mbrojtësit të viktimave që nga dëshmitarët e ZPS-së dhe të Mbrojtjes të nxjerrë informacion me rëndësi për procesin e zhdëmtimit. Gjithashtu, në pajtim me rregullën 143(4) të Rregullores, kryegjykatësi i Trupit Gjykses mund në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pyetjen e dëshmitarëve për të shmangur, ndër të tjera, pyetjet përsëritëse.

41. Në lidhje me renditjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, rregulla 127(3) e Rregullores parashikon që një dëshmitar fillimisht pyetet nga pala thirrëse dhe pastaj

nga pala kundërshtare, por nuk përcakton se kur mbrojtësi i viktimave supozohet të pyesë dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja apo nga Mbrojtja. Trupi Gjykses e vlerëson të arsyeshme që dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja të pyeten nga mbrojtësi i viktimave pas marrjes së tyre në pyetje nga ZPS-ja, në mënyrë që Mbrojtja të mund të marrë parasysh përgjigjet që dëshmitarët i kanë dhënë ZPS-së dhe mbrojtësit të viktimave kur t'i marrë ata në pyetje. Në lidhje me dëshmitarët e thirrur nga Mbrojtja, ata fillimisht do të pyeten nga ZPS-ja si palë kundërshtare dhe pastaj nga mbrojtësi i viktimave. Sa u takon dëshmitarëve të thirrur nga Trupi Gjykses me kërkesë të mbrojtësit të viktimave, ata fillimisht do të pyeten nga mbrojtësi i viktimave, pastaj nga ZPS-ja dhe në fund nga Mbrojtja. Sa u takon dëshmitarëve të thirrur nga Trupi Gjykses *proprio motu*, ata fillimisht do të pyeten nga Trupi Gjykses, pastaj nga ZPS-ja, më tej nga mbrojtësi i viktimave dhe në fund nga Mbrojtja.

#### **6. Parashtrime në lidhje me pranueshmërinë e provave të paraqitura nga palët**

42. Trupi është i mendimit që kur janë në pyetje interesat personale të viktimave, mbrojtësi i viktimave duhet të lejohet të bëjë parashtrime në lidhje me pranueshmërinë e provave të paraqitura nga ZPS-ja apo Mbrojtja, në të njëjtën mënyrë sikurse mund t'i kërkojë Trupit Gjykses të urdhërojë parashtrimin e provave përkatëse apo të thërrasë dëshmitarë. Rrjedhimisht, mbrojtësi i viktimave mund t'i kërkojë Trupit Gjykses të ushtrojë kompetencën e vet të marrjes së vendimit për pranueshmërinë e provave të paraqitura nga ZPS-ja apo Mbrojtja, në pajtim me nenin 40(6)(h) të Ligjit.

#### **IV. VENDIM**

43. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:



- a. **MIRATON** përkufizimet e lartpërmendura të interesave personale dhe të drejtave të viktimave, sikurse përcaktohen në paragrafët 9 deri 19 më lart; dhe
- b. **MIRATON** të drejtat procedurale të viktimave gjatë gjykimit, sikurse përcaktohen në paragrafët 25 deri në 42 më lart.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**

**Kryegjykatëse e Trupit Gjykses**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Roland Dekers**

E hënë, 12 korrik 2021

Në Hagë, Holandë.